

REKOMANDIME PËR PËRDORIM TË SIGURT TË SHËRBIMEVE BANKARE ELEKTRONIKE NË KURSIMOREN MOZHNOSTI

PËRDORIMI I FJALËKALIMIT

Pasi të aplikoni për përdorimin e shërbimeve bankare elektronike, Kursimorja do t'ju caktojë një fjalëkalim për një përdorim nëpërmjet adresës suaj e-mail. Pas hyrjes fillestare, duhet ta zëvendësoni menjëherë këtë fjalëkalim me një fjalëkalim tuajin. Fjalëkalimi rekomandohet të jetë kompleks, që do të thotë se duhet të ketë të paktën 8 karaktere në përmbajtjen e tij - (numra, shkronja dhe karaktere speciale). Bëjeni fjalëkalimin e ri më kompleks dhe të lehtë për t'u mbajtur mend na ana juaj. Në këtë mënyrë, nëse jeni në shënjestër të sulmit, kompleksiteti i fjalëkalimit në një farë mase do ta pamundësojë ose së paku do ta ngadalësojë hyrjen në llogarinë tuaj.

Vlefshmëria e fjalëkalimit për një përdorim është 24 orë dhe pasi kalon ky afat ai bëhet joaktiv. Pas skadimit të vlefshmërisë së fjalëkalimit për një përdorim, që të mund t'ju caktohet një fjalëkalim i ri për një përdorim, ju duhet të telefononi në "Mozhnosti", ku do të merrni udhëzime të qarta se si duhet të veproni.

Për fjalëkalimet, mos përdorni kurrë emrin tuaj, mbiemrin ose emrin e personave tuaj të afërt, inicialet, datën e lindjes ose frazat e zakonshme ose fjalë që janë të lehta për t'u zbuluar.

Rekomandohet që ta ndryshoni fjalëkalimin Tuaj herë pas here. Nëse dyshoni se dikush përreth jush e ka zbuluar në ndonjë farë mënyre fjalëkalimin tuaj, ndryshojeni sa më shpejt që të jetë e mundur.

Fjalëkalimi juaj duhet të jetë unik vetëm për përdorimin e këtij shërbimi, ose mos përdorni të njëjtin fjalëkalim që përdorni për rrjete të tjera – e-mail, rrjete sociale, portale interneti, forume etj. Mos e mbani fjalëkalimin tuaj të shkruar në letër në një vend publik, në portofol, në numërorin e telefonit tuaj celular, ose në ndonjë pjesë tjetër të sendeve tuaja personale, por përpiquni që ta mbani mend atë.

Nëse jeni regjistruar në e-banking, mos e lini kurrë kompjuterin tuaj të hapur. Nëse e bëni këtë në një vend ku shpesh kalojnë njerëz të tjerë, mashtruesit të mundshëm ia keni lënë hapur të gjitha dyert për të pasur qasje në informacionet tuaja financiare.

Në rrethanat kur përkohësisht largoheni nga kompjuteri juaj, duhet që patjetër të bëni mbylljen e tij (lock workstation). Mbani në mend faktin që aplikacioni për e-banking automatikisht do të dalë nga sesioni juaj vetëm pas kalimit të 15 - 20 minutave në pasivitet.

MBROJTJA E KOMPJUTERIT NGA KU QASENI

Sigurohuni që në kompjuterin tuaj ose në kompjuterin nga i cili qaseni në sistemin e-banking të Kursimores "Mozhnosti" është instaluar më parë softueri i duhur i mbrojtjes si antivirus, firewall, anti spam etj. Sisteme të tilla të parandalimit, të instaluara në kompjuterin tuaj, duhet që të përditësohen (update) rregullisht çdo ditë me përditësimet më të fundit të sigurisë të ofruara nga prodhuesi. Rregullisht instaloni arna të sigurisë në sistemin tuaj operativ, kështu që ju do të jeni të mbrojtur nga kompromentimi i tij.

QASJA DHE PËRDORIMI I E-BANKINGUT

Kur të hyni në sistemin e e-bankingut të Kursimores “Moznosti”, përdorni vetëm kompjuterin, telefonin celular ose tabletin tuaj. Mos përdorni hyrje nga internet - kafe, biblioteka, telefona ose tablete të huaja dhe mos e përdor sistemin duke hyrë nëpërmjet një rrjeti të paverifikuar të WI-FI.

Mos përdorni rrjetin falas Hot Spot, i cili mund të gjendet në qendra tregtare, aeroporte, kafene etj.

Një kompjuter që nuk është në pronësinë tuaj, gjithmonë ka mundësi të hapur që të infektohet me ndonjë kod dashakeqës. Nëse vendosni të përdorni një kompjuter që nuk është juaji, atëherë pas përfundimit të aktivitetit, në mënyrë të detyrueshme fshijeni kujtesën cache të shfletuesit të internetit dhe mbylleni aplikacionin.

Për qasje në e-banking përdorni faqen zyrtare të internetit të Kursimores “Moznosti”, duke u siguruar se po përdorni një protokoll https të cilin mund ta shihni në shiritin e URL-së të shfletuesit tuaj të internetit (p.sh. <https://www.eclick.moznosti.com.mk>).

Qasja **e-banking** nëpërmjet lidhjeve të marra prej postës elektronike ose të ekspozuar ndaj sajteve të treta, pavarësisht nëse bëhet fjalë për gazeta në Internet, faqe sociale (Facebook, LinkedIn, Instagram, Twitter), blogje, etj, në thelb e përmbajnë rrezikun që të përfundoni në rrjetin e mashtruesve dhe të bëheni viktimë e vjedhjes së identitetit tuaj digjital.

Pas përfundimit të aktivitetit të e-bankingut, gjithmonë detyrimisht dilni dhe mos lejoni që sistemi të shkyçet vetë. Përdorni Log off, d.m.th. mbylleni sesionin dhe në këtë mënyrë ju do të pamundësoni çdo abuzim të mundshëm të kodit keqdashës që të ketë qasje.

MESAZHE E-MAIL DHE KONTAKTI ME KURSIMOREN

Sipas politikës së Kursimores, ajo kurrë nuk do t'ju dërgojë një mesazh e-mail nëpërmjet të cilit do t'ju kërkojë të jepni informacione për emrin dhe fjalëkalimin tuaj për sistemin e e-bankingut. Në rast të një mesazhi të tillë të postës elektronike ose të ndonjë mesazhi të dyshimtë ju lutemi që të kontaktoni menjëherë shërbimet e Kursimores nëpërmjet numrave të telefonave publik që janë në dispozicion, ku do t'ju japin udhëzime shtesë.

Nëse merrni ndonjë telefonatë nga Kursimorja, punonjësit kurrë nuk do t'ju kërkojnë fjalëkalimin tuaj të qasjes në e-banking. Nëse dyshoni se thirrja është nga Kursimorja menjëherë ndërpriteni thirrjen dhe paraqituni në numrat e telefonave publikë të disponueshëm në numërorin telefonik ose në ueb faqen e korporatës.

MONITORIMI I LLOGARIVE TUAJA

Me hapjen e profilit të përdoruesit në bankën elektronike të Kursimores “Moznosti”, Ju jeni në gjendje që rregullisht dhe menjëherë të monitoroni llogaritë tuaja kreditore dhe ato të kursimeve.

Nëse vini re ndonjë ndryshim që nuk e keni bërë, sado i vogël qoftë ai, menjëherë kontaktoni Kursimoren për informata më të hollësishme.

Sistemi elektronik bankar i Kursimores “Moznosti” është një mjedis i sigurt për përdorim dhe qasje për sa kohë që do t'i ndiqni rekomandimet e përshkruara më lart.